

Edukimi shëndetësor,prill 2014-05-15

Në muajin prill, Qendra e shëndetit publik-Shkup përmes raportit për edukim shëndetësor,vazhdon me edukimin shëndetësor për rruajtjen dhe përparimin e shëndetit të popullatës në rajonin e Shkupit. Në shkollat fillore dhe të mesme në zonat që i mbulon Qendra, ishin të mbajtura gjithsej 152 ligjërata ku ishin të përfshirë 1693 nxënës. Gjithashtu, ishte mbajtur tribunë me temën: ushqim të shëndetshëm shkollor dhe rreziku shëndetësor nga ushqimi jo i rregullt, të përfshirë 35 nxënës.

Ligjëratat edukative të nxënësve në shkollat e mesme ishin të mbajtura në komunën e Aerodromit,Gazi Babës dhe Harçinës. Në komunën e Haraçinës ishin të përfshirë fshatrat Orllancë dhe Grushinë. Në komunat e përmendura, ligjëratat edukative ishin të mbajtura në shkollat e mesme në vijim.

- Në komunën e Aerodromit –Sh. F.,, Braqa Milladinovci”
- Në komunën e Gazi Babës –Sh. F.,, Grigor Prliçev”
- Në komunën e Haraçinës – Sh. F.,, Gjergj Kastrioti Skenderbeu” dhe Sh. F.,,Bajram Shabani”.

Në shkollat ishin të mbajtura gjithsej 102 ligjërata, ku ishin të përfshirë 1152 nxënës në temat në vijim.

- Higjiena personale dhe parandalimi nga uji i pijshëm i pa sigurt
- Ushqim i shëndetshëm shkollor dhe rreziku shëndetësor nga ushqimi jo i rregullt
- Përfitimet mjekësore nga aktivitetet e rregullta
- Sëmundjet e varësisë

Edukimi në shkollat e mesme,ishte realizuar në komunën e Gjorge Petrovit në shkollën e mesme SHMQSH ,,Koço Racin . Në shkollat e përmendura ishin të mbajtura gjithsej 50 ligjërata të përfshirë 541 nxënës. Ligjëratat ishin të mbajtura në temat në vijim.

- Infeksionet seksuale të transmetueshme
- Ushqim i shëndetshëm shkollor dhe rreziku shëndetësor nga ushqimi jo i rregullt

Në shkollat, në ligjërata ishin të shpërndara materiale promovuese.

